2020

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Zhvillimit Rajonal*
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*
*Ministry of Regional Development*

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE RAJONALE

# ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO – EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR NË KOSOVË - VITI 2019

Korrik, 2020

*Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe i njëjti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, ministrive të linjës dhe komunave të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve të vazhdueshme për përkrahje të sektorit privat në Kosovë.*

**DOKUMENTI U PUNA NGA:**

Blerim Hasani, Drejtor I Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale
Vjendita Avdiu Musliu, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal të Balancuar
Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio – Ekonomik

Copyright. 2019 – Ministria e Zhvillimit Rajonal
Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë
Tel. +381 (0) 38 64 516 / https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/

## Përmbajtja:

Lista e shkurtesave ________________________________________ 3

I.Hyrje ________________________________________ 4

II.Implementimi i programeve nga Ministritë e linjës në vitin 2019 për përkrahje të sektorit privat – bizneseve në Kosovë ________________________________________ 5

2.1 Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019) nga MZHR ________________ 5

2.2 Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI ________________________ 7

2.3 Programi për përkrahjen e bizneseve fillestare në fushën e inovacionit dhe ndërrmarrësisë nga MIN për v.2019 ________________________________________ 9

III. Përkrahja e sektorit privat në Rajonin Zhvillimor Qendër________________________ 11

3.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës në RZHQ ________________12

IV. Rajoni Zhvillimor Jug ________________________________________16

4.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës në RZHJ ________________ 17

V.Rajoni Zhvillimor Perëndim ________________________________________ 20

5.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës në RZHP ________________ 21

VI. Rajoni Zhvillimor Veri ________________________________________ 24

6.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës në RZHV ________________ 25

VII.Rajoni Zhvillimor Lindje ________________________________________ 28

7.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës në RZHL ________________ 29

VIII. Paraqitja grafike e të dhënave rajonale ________________________________ 33

IX.Shuma e përgjithëshme e investimeve në (%) duke përfshi 3 Lotet në pesë(5) rajonet zhvillimore në Kosovë ________________________________________ 36

X. Shuma e përgjithëshme e bashkëfinancimeve në (%) nga bizneset në tre Lotet në pesë rajonet zhvillimore në Kosovë________________________________________ 37

XI. Shuma e përgjithëshme e investimeve në (%) në bazë të përkatësisë etnike ________________ 37

XII. Paraqitja tabelare e projekteve sipas komuniteteve ________________________ 38

XIII. Paraqitja grafike e projekteve të udhëhequra në baza gjinore ________________38

XIV. Analiza e pyetësorit t realizuar nga MZHR nga PZHRG ( 2018-2019)________________ 40

XV. Përfundime ________________________________________ 49

XVI. Burimet e informacionit ________________________________________ 50

### Lista e shkurtesave:

MZHR- Ministria e Zhvillimit Rajonal

MIN- Ministria e Invovacionit dhe Ndërmarrësisë

MTI – Ministra e Teknologjise Informative

PZHRB (2019) – Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (2019)

PZHR (2019) - Programi për Zhvillim Rajonal (2019)

AZHR- Agjensioni për Zhvillim Rajonal

RZHK- Rajonet Zhvillimore të Kosovës

RZHQ - Rajoni Zhvillimor Qendër

RZHL- Rajoni Zhvillimor Lindje

RZHJ- Rajoni Zhvillimor Jug

RZHV- Rajoni Zhvillimor Veri

RZHP - Rajoni Zhvillimor Perëndim

## I. HYRJE

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me shtojcën 16 të Rregullores (QR) Nr. 07/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e punës për vitin 2020, ka përgatitur "Analizën për zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë për vitin 2019".

Bazuar në mandatin e saj ligjor, MZHR zhvillon dhe menaxhon programe për të ofruar zhvillim socio – ekonomik rajonal të balancuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe bënë promovimin e tyre. Kjo analizë, hyn edhe në kuadër të kompetencës se MZHR-së për "Përgatitjen e analizave lidhur me zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar". Në këtë analizë, trajtohet përkrahja e MZHR-së dhe ministrive të linjës ndaj sektorit privat – bizneseve e realizuar në vitin 2019. Trajtohen programet – skemat për dhënien e granteve të implementuara edhe nga Ministritë e linjës në vitin 2019 (MTI) dhe (MIN), shumat totale të subvencionimit, numri i aplikimeve dhe përfituesve sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave, sektorët përfitues dhe krahasueshmeria e tyre ndërmjet rajoneve, vendet e reja të punës, përkatësia etnike e përfituesve, si dhe përfituesit në bazë të gjinisë.Gjithashtu MZHR për të pasqyruar në mënyrë sa më transparente impaktin që ka pas PZHRB tek përfituesit gjatë dy viteve të fundit (2018-2019) ka realizuar edhe një pyetësor te aprovuar nga Sekretari i MZHR-së i cili është distribuuar tek një numër prej 200 përfituesve.Përgjigjet e pranuara janë analizuar dhe trajtuar në dokument përmes paraqitjes grafike, numerike dhe të përqindjeve si dhe analizës teorike të vet rezultateve që ka gjeneruar ky pyetësor.

Përgjithësisht, këto janë çështjet kryesore që e përbëjnë "Analizën për zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë për vitin 2019".

Përmes publikimit të kësaj, analize MZHR synon të stimuloj zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar ndërmjet pesë (5) rajoneve zhvillimore: rajonin Qendër, rajonin Veri, rajonin Perëndim, rajonin Lindje dhe rajonin Jug. Pasqyrohet subvencionimi i bizneseve duke paraqitur zgjerimin e kapaciteteve të tyre pas pranimit të përkrahjes nga shteti, rritjen e qarkullimit, shtimin e kapaciteteve prodhuese dhe njerezore, etj.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Zhvillimit Rajonal ( MZHR) ka implementuar "Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2019", i cili është realizuar përmes Grant Skemës për mbështetje financiare të bizneseve me projekte në tërë territorin e Kosovës.

Në raportin e përgatitur nga Departmenti për Zhvillim Rajonal (DZHR) për implementimin e Programit, potencohet se në vitin 2019 nga MZHR në të gjitha rajonet zhvillimore, janë përkrahur 201 projekte dhe janë krijuar 751 vende të reja të punës. Shuma totale e financimit është rreth 2.4 milion. Gjithashtu, në Analizë trajtohen dhe pasqyrohen edhe subvencionet për biznese të dhëna në vitin 2019 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN).Të tre këto programe, kanë elemente të ngjajshme në aspekt të kualifikueshmerisë së llojeve

të bizneseve që janë përkrahur dhe sektorëve. Prandaj, marrë parasysh këtë, në këtë analizë janë trjatuar tre(3) programe, të cilat fokusin kryesor kanë pas zgjerimin e kapacitetve të bizneseve për rritjen e prodhimit, gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksportit.

## II. Implementimi i programeve nga Ministritë e linjës në vitin 2019 për përkrahje të sektorit privat – bizneseve në Kosovë

Marrë parasysh mandatin ligjor dhe buxhetin e aprovuar me Ligjin vjetor të buxhetit, disa ministri të Qeverisë së Republikës së Kosovës, zhvillojnë dhe realizojnë programe për përkrahje të bizneseve apo sektorit privat. Secila përkrah bizneset për një apo disa sektor, varësisht prej fushës që e mbulon dhe buxheti që e ka të aprovuar paraprakisht për realizimin e programit/eve përkatëse.

Viti 2019 është viti i dytë që Ministria e Zhvillimit Rajonal implemenon programin për përkrahje të bizneseve "Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)". Në dy vitet (2018 – 2019), MZHR ka përkrahur bizneset kryesisht në sektorin e prodhimit, duke mos i përjashtuar dhe TI-në dhe shërbimet. Në vitin 2019, është përjashtuar sektori i bujqësisë (për pajisjet që financohen nga MBPZHR), ndërtimit, shëndetësisë dhe tregtisë. Për dallim nga viti 2018 ku MZHR ka pasqyruar vetëm grantet e shpërndara nga ky program, në vitin 2019 në këtë analizë ka përfshirë edhe grantet për biznese të financuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërrmarrësisë. Kjo është arritur përmes sigurimit të dhënave dhe bashkëpunimi të mirë e të vazhdueshëm ndër-institucional, ndërmjet MZHR-së, MTI-së dhe MIN.

Marrë parasysh ngjajshmerinë e programeve lidhur me kualifikueshmerinë e llojeve të bizneseve (mikro, të vogla dhe të mesme) dhe sektorëve (prodhimit) në të cilët janë përkrahur bizneset nga M.L në vitin 2019, në këtë analizë trajtohen dy (2) programe të realizuara për përkrahje të bizneseve:

1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019), realizuar nga MZHR;
2. Programi për përkrahjen e NMVM-ve, i realizuar nga KIESA/MTI;
3. Programi për përkrahjen e bizneseve fillestare në fushën e inovacionit dhe ndërrmarrësisë nga MIN për v.2019

Programet në fjalë, përgjithësisht nuk dallojnë shumë edhe për nga synimet që i kanë të përcaktuara për përkrahjen e bizneseve kryesisht që merren me prodhim. Zgjërimi i kapaciteteve biznesore, gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe zëvendësimi i importit dhe rritja e eksportit, janë objektivat kryesore e tre (3) programeve.

Mbi bazën e kapaciteteve profesionale në dispozicion, funksionimit të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndër-institucional, MZHR do të vazhdojë përpjekjet që të përfshijë edhe programe tjera në analizat e viteve vijuese.

### 2.1 Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019) nga MZHR

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2019, është realizuar përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së granteve për biznese, e shpërndarë në lote.

Përkufizimi i lotëve dhe mjetet e dedikuara për secilin lot, kanë qenë si vijon:

- <u>Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare)</u>
  Nga 2,000 € deri në 5,000 €

- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet)
  Nga 5,000 € deri në 15,000 €;

- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet)
  Nga 15,000 € - 25,000 €.

Skema e granteve bazuar në "Programin Zhvillimor Rajonal të balancuar" gjatë vitit 2019 ka mbështetur në total 201 projekte te cilat janë shpërndarë si mëposht:

- Në rajonin socio-ekonomik Qendër (Komuna e Prishtinës me komunat për rreth), janë përkrahur 43 (dyzet e tri) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik Lindje (Komuna e Gjilanit me komunat për rreth), janë përkrahur 42 (dyzet e dy) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik Perëndim (Komuna e Pejës me komunat për rreth), janë përkrahur 40 (dyzet) projekte;
- Në rajonin socio ekonomik Veri (Komuna e Mitrovicës Jugore me komunat për rreth), janë përkrahur 37 (tridhjet e shtatë) projekte;
- Në rajonin socio-ekonomik Jug (Komuna e Prizrenit me komunat për rreth, tridhjetë e nëntë (39) projekte .

Në kuadër të Skemës së PZHRB (2019) në total MZHR ka pranuar 1686 aplikacione në pesë ( 5) rajonet zhvillimore me të cilat operon apo në:

- Në L1 janë pranuar 702 aplikacione
- Në L2 janë pranuar 213 aplikacione
- Në L3 janë pranuar 771 aplikacione

Në krahasim me vitin 2018 ku MZHR ka pranuar 1696 aplikacione ,shohim një ulje minimale të numrit të aplikuesve për 10 aplikues më pak në krahasim me numrin total të aplikuesve në vitin 2019.Në vitin 2019 vërehet një rritje e numrit të aplikimeve në L3 për 41 aplikime më shumë se në v.2018.

Për të paraqitur më qart aplikimet që kemi pranu gjatë v.2018 në kuadër të Skemës së PZHRB (2018) gjeni mëposht të ndara në Lote aplikacionet që MZHR ka pranuar në pesë ( 5) rajonet zhvillimore me të cilat operon. Në total janë pranuar 1696 aplikacione apo në:

- Në L1 janë pranuar 733 aplikacione
- Në L2 janë pranuar 233 aplikacione
- Në L3 janë pranuar 730 aplikacione

Sa i përket numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në (5) pesë rajonet zhvillimore të Kosovës në kuadër të PZHRB ( 2019 ) , në vitin 2019 janë 751 të punësuar ku nga ata në:

- Rajonin Zhvillimor Qendër - 164 persona
- Rajonin Zhvillimor Lindje - 152 persona
- Rajonin Zhvillimor Perëndim - 150 persona
- Rajonin Zhvillimor Veri - 108 persona
- Rajonin Zhvillimor Jug - 177 persona.

Bazuar në mandatin e MZHR-së që ka për synim zvogëlimin e papunësisë dhe pabarazive sociale , nga programi (PZHRB 2019) ka pasë rritje në numrin e të punsuarve, ku gjatë v.2019 janë punësuar 751 persona ndërsa gjatë v. 2018 kanë qenë 561 të punësuar.Viti 2019 ka një rritje mjaft të madhe në punësim me një numër prej 190 të punësuar më shumë, të gjithë të dëshmuar përmes deklarimeve në ATK.

Llojet e veprimtarive të projekteve të mbështetura nga Grant Skema për Zhvillim Rajonal të Balacuar (2019), kanë përfshirë më së shumti veprimtaritë prodhuese dhe të përpunimit si dhe shërbimeve nga më të ndryshmet si: konsulencë, teknologji informative, inxhinieri, shërbime automekanike/ autoservisim , shërbime të mjekësisë, floktarisë, rrobaqepësisë, dizajn, shërbime të pastrimit etj. Veprimtaritë prodhuese kanë qenë më së shumti të orientuara në: prodhimet e miellit, përpunimit të mishit të shpezëve, prodhime të materialeve të tekstilit dhe plastikës, prodhimin dhe përpunimin e hekurit,drurit, metalit,prodhim i akullit,prodhim dhe përpunim i mobiljeve, prodhimin dhe përpunimin e çajreve, frutave, produkteve malore, ëmbëlsirave etj.

Në tabelat e mëposhtme do të mund të shihni në formë më të detajuar të gjitha projektet e financuara për vitin 2019 nga MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal në (5) pesë rajonet socio-ekonomike në Kosovë, të ndara në Lot1, Lot2 dhe Lot 3 , të cilat do të pasqyrojnë në mënyrë më të qartë shpërndarjen e balancuar të projekteve dhe financimeve nëpër Komuna si dhe ndikimit që ka pas programi zhvillimor në zhvillimin rajonal të balancuar në tërë territorin e Kosovës i cili program ka investuar shumën totale prej 2,387,769.45 € në (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore. Ndërsa vlera totale e bashkëfinancimit në v. 2019 nga bizneset përfituese për pesë (5) rajonet zhvillimore është 707,537.79€.

## 2.2 Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI

Në vitin 2019, për përkrahje të bizneseve apo konkretisht ndërmarrejeve te vogla dhe të mesme, një program të veçantë e ka implementuar edhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)/Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Qëllimi i realizimit të këtij programi, ishte ngritja e kapaciteteve prodhuese, konkretisht përkrahja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesmë për blerjen e makinerisë prodhuese. Buxheti në total për realizimin e këtij programi, ishte në shumë prej afërsisht : 700,000.00 (shtatëqind mijë )Euro.

Thirrja për aplikim/Skema e publikuar nga MTI, përmbante kategoritë si vijon:

- Për ndërmarrjet mikro (të punësuar 1 deri 9 punëtor) vlera totale e granteve ishte 360,000.00 EUR. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje mikro është deri në 75% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare deri në 20,000.00 EUR;

- Për ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtor) vlera totale e granteve do të jetë 240,000.00 EUR. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e vogël është deri në 50% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare deri në 30,000.00 EUR;

- Për ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri 249 punëtor) vlera totale e granteve do të jetë 100,000.00 EUR. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e mesme është deri në 50 % e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare deri në 50,000.00 EUR.

Me kërkesë të MZHR-së, MTI ka siguruar listën e përfituesve (bizneseve) me numër të regjistrimit, ku janë listuar 28 (njëzet e tetë) ndërmarrje përfituese. Mirëpo, KIESA/MTI nuk ofron vlerat financiare të subvencioneve dhe bashkëfinancimeve të ndara në komuna, ku këtë e arsyeton me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit të ndërmarrjeve përfituese.

Mbi bazën e numrit të regjistrimit dhe sistemit elektronik të ARBK-së, MZHR evidentoj bizneset se cilave komuna ju përkasin dhe i pasqyroj sipas rajoneve dhe komunave në kapitujt në vijim.

*Tabela 1, përfituesit e NMV-ve nga MTI*

**Përfituesit e granteve për biznese v.2019 nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë**

| Rajonet | Komunat | Ndërmarrjet mikro (1 deri 9 punëtor) | | Ndërmarrjet e vogla (10 deri 49 punëtor) | | Ndërmarrjet e mesme ( 50 deri 249 punëtor) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. I projekteve | Vlera(€) | Nr. I projekteve | Vlera (€) | Nr. I projekteve | Vlera (€) |
| QENDËR | Prishtinë | 11 | 201,350.00 | 1 | 30,000.00 | / | 0 |
| | Drenas | 1 | 20,000.00 | / | 0 | / | 0 |
| | Fushë Kosovë | / | 0 | 1 | 30,000.00 | / | 0 |
| | Graçanicë | / | 0 | 2 | 60,000.00 | / | 0 |
| | Lipjan | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Obiliq | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Podujevë | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Shtime | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| **TOTALI QENDËR** | | **12** | **221,350.00** | **4** | **120,000.00** | **/** | **0** |
| JUG | Prizren | 2 | 40,000.00 | / | 0 | / | 0 |
| | Dragash | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Malishevë | 1 | 20,000.00 | / | 0 | / | 0 |
| | Mamushë | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Rahovec | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Suharekë | / | 0 | 2 | 60,000.00 | / | 0 |
| **TOTALI JUG** | | **3** | **60,000.00** | **2** | **60,000.00** | **/** | **0** |
| LINDJE | Gjilan | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Novobërdë | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Kamenicë | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Ferizaj | 1 | 20,000.00 | / | 0 | 1 | 50,000.00 |
| | Kaçanik | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Shtërpcë | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | Viti | / | 0 | / | 0 | / | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Hani i Elezit** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Kllokot** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Ranillugë** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Partesh** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| **TOTALI LINDJE** | | **1** | **20,000.00** | **/** | **0** | **1** | **50,000.00** |
| **PERËNDIM** | **Pejë** | / | 0 | 2 | 60,000.00 | / | 0 |
| | **Istog** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Deçan** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Junik** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Klinë** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Gjakovë** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| **TOTALI PERENDIM** | | **/** | **0** | **2** | **60,000.00** | **/** | **0** |
| **VERI** | **Mitrovicë** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Skenderaj** | 1 | 19,000.00 | / | 0 | / | 0 |
| | **Vushtrri** | 1 | 20,000.00 | / | 0 | 1 | 50,000.00 |
| | **Mitrovica e V.** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Leposaviq** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Zveqan** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| | **Zubin Potok** | / | 0 | / | 0 | / | 0 |
| **TOTALI VERI** | | **2** | **39,000.00** | **/** | **0** | **/** | **50,000.00 €** |
| **TOTALI I PËRFITUESËVE/VLERAT** | | **18** | **340,350.00** | **8** | **240,000.00** | **2** | **100,000.00** |

Nga Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI, sipas të dhënave të siguruara nga MTI, rezultatet e numrit të projekteve përfituese (28 projekteve) janë si vijon:

- 16 projekte në Rajonin Zhvillimor Qendër.
- 2 projekte në Rajonin Zhvillimor Lindje.
- 3 projekte në Rajonin Zhvillimor Veri.
- 5 projekte në Rajonin Zhvillimor Jug.
- 2 projekte në Rajonin Zhvillimor Perëndim.

Nga të dhënat e sipërcekura shohim se numrin më të madh të projekteve nga programi i përkrahjes së NMV-ve për v.20196 nga MTI e ka përfituar rajoni zhvillimor Qendër me një diferencë mjaft të madhe prej gjashtëmbëdhjetë(16) projekteve nga totali i njëzet e tetë (28)projekteve.

## 2.3 Programi për përkrahjen e bizneseve fillestare në fushën e inovacionit dhe ndërrmarrësisë nga MIN për v.2019

Me qëllim të përkrahjes së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në funksion të fuqizimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) sipas vendimit Nr. 151/2019 të datës 04/03/2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë ka shpalle në v.2019 programin (fondin) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Bizneseve Fillestare – "Start-up", i cili është dizajnuar për të financuar bizneset e reja dhe iniciativat/idetë për krijimin e bizneseve të reja inovative, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Financimi i "Start-Up" synon fuqizimin ekonomik të të rinjve, në jetësimin e ideve inovative dhe planeve të bizneseve.

*Tabela 2, përfituesit e NMV-ve nga MIN*

| Përfituesit e granteve për biznese për v.2019 nga Ministria e Inovacionit sipas rajoneve zhvillimore | | | |
|---|---|---|---|
| **Rajonet Zhvillimore** | **Komunat** | **START-UP** | **Vlera e shpenzuar e projektit (€)** |
| **QENDËR** | Prishtinë | 39 | 342,408.60 |
| | Drenas | 1 | 9,000.00 |
| | Fushë Kosovë | 1 | 9,000.00 |
| | Graçanicë | / | / |
| | Lipjan | 2 | 18,000.00 |
| | Obiliq | / | / |
| | Podujevë | / | / |
| | Shtime | 1 | 9,000.00 |
| **TOTALI NË RAJONIN QENDËR** | | **44** | **387,408.60** |
| **JUG** | Prizren | 2 | 17,325.00 |
| | Dragash | / | / |
| | Malishevë | / | / |
| | Mamushë | / | / |
| | Rahovec | / | / |
| | Suharekë | 1 | 9,000.00 |
| **TOTALI NË RAJONIN JUG** | | **3** | **26,325.00** |
| **LINDJE** | Gjilan | 4 | 33,050.70 |
| | Novobërdë | / | / |
| | Kamenicë | / | / |
| | Ferizaj | 2 | 17,987.40 |
| | Kaçanik | / | / |
| | Shtërpcë | / | / |
| | Viti | / | / |
| | Hani i Elezit | / | / |
| | Kllokot | / | / |
| | Ranillugë | / | / |
| | Partesh | / | / |
| **TOTALI NË RAJONIN LINDJE** | | **6** | **51,038.10** |
| **PERËNDIM** | Pejë | 3 | 26,505.00 |
| | Istog | 1 | 8,730.00 |
| | Deçan | 3 | 25,371.00 |
| | Junik | / | / |
| | Klinë | 3 | 26,064.00 |
| | Gjakovë | 2 | 16,969.50 |

| TOTALI NË RAJONIN PERËNDIM | | 12 | 103,639.50 |
|---|---|---|---|
| VERI | Mitrovicë | 2 | 18,000.00 |
| | Skenderaj | 3 | 27,000.00 |
| | Vushtrri | 2 | 18,000.00 |
| | Mitrovica e V. | / | / |
| | Leposaviq | / | / |
| | Zveqan | / | / |
| | Zubin Potok | / | / |
| TOTALI VERI | | 7 | 63,000.00 |
| TOTALI I PËRFITUESËVE NË PESË (5) RAJONE | | 72 | 631,411.20 |

Nga Programi për përkrahjen e bizneseve fillestare në fushën e inovacionit dhe ndërrmarrësisë për v.2019 nga MIN, sipas të dhënave të siguruara nga MIN me kërkesë të MZHR-së , rezultatet e numrit të projekteve përfituese (72 projekteve) janë si vijon:

- 44 projekte në Rajonin Zhvillimor Qendër.
- 6 projekte në Rajonin Zhvillimor Lindje.
- 7 projekte në Rajonin Zhvillimor Veri.
- 3 projekte në Rajonin Zhvillimor Jug.
- 12 projekte në Rajonin Zhvillimor Perëndim.

Nga numri i përgjithëshëm i financimit dhe përkrahjes së bizneseve fillestare në fushën e inovacionit dhe ndërrmarrësisë për v.2019 nga MIN , katërdhjetë e katër (44) projekte janë mbështetur në rajonin zhvillimor Qendër , e cila vlerë konsiston në një diferencë shumë e madhe në krahasim me numrin e projekteve përfituese në rajonet tjera zhvillimore.

### III. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Qendër

Rajoni Zhvillimor Qendër përshin tetë ( 8) Komuna: (Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Shtime, Podujevë Obiliq dhe Lipjan).

Nga tre (3) programet (MZHR,MIN dhe MTI), në rajonin zhvillimor Qendër, janë përkrah:

- 43 ( katërdhjetë e tre) biznese nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2019 (PZHRB 2019 – MZHR), në vlërë prej 518,406.21€ ;
- 16 ( gjashtëmbëdhjetë ) NMVM nga Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI në vlerë 341,350.00€
- 44 ( katërdhjetë e katër) biznese nga programi për përkrahjen e bizneseve fillestare nga MIN në Rajonin Zhvillimor Qendër në vlerën 387,408.60 €

Nëse krahasojmë Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018 (PZHRB 2018 – MZHR) me PZHRB (2019), shohim se numri i projekteve të financuara nga MZHR gjatë vitit 2019 është rritur për 13 projekte më shumë, gjë që nënkupton që në vitin 2018 MZHR ka mbështetur në total 30 projekte në RZHQ , ndërsa në v.2019 43 projekte në RZHQ. Nëse e analizojmë shumën totale të financimit PZHRB 2018 shohim se MZHR ka financuar vlerën prej 277,211.75€ ndërsa në v.2019 vlera e financimit nga MZHR është 518,406.21€. Nga vlerat e sipër cekura shohim se MZHR ka dyfishuar vlerën e financimit në rajonin zhvillimor Qendër për 241,194.46 € më shumë.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2019) në rajonin zhvillimor Qendër janë pranuar 567 aplikacione në tre (3) Lotet (1,2,3) nga tetë (8) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 567 , në kategrinë:

- Në Lot 1 janë pranuar 235 aplikacione
- Në  Lot 2 janë pranuar 83 aplikacione
- Në Lot 3 janë pranuar 249 aplikacione

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) Nga 2,000 € deri në 5,000 €
    - Njëze e një (21) projekte në vlerë 94,700.60€
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) Nga 5,000 € deri në 15,000 €;
    - Tetë (8 )projekte në vlerë 106,100.00€
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) Nga 15,000 € - 25,000 €.
    - Katërmbëdhjetë (14) projekte në vlerë 317,605.61€

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2019) në RZHQ

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) - 32,270.26€
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) - 34,448.33€
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) - 93,477.49€

Totali i bashkëfinancimit për 3 (tre ) lotet në Rajonin Zhvillimor Qendër është 160,196.08€

### 3.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019), rë rajonin zhvillimor Qendër, sektori më i financuar janë shërbimet me një numër të projekteve prej 34 ( tridhjetë e katër) duke viju me prodhim ku janë financuar gjithësejt 9 ( nëntë) projekte.

Punësimi nëper Lote në RZHQ sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- LOT 1 – Janë 64 të punësuar:
- LOT 2 – Janë 29 të punësuar:
- LOT 3 – Janë 71 të punësuar:

Në total për v.2018 në kuadër të PZHRB ( 2018) janë 177 të punësuar duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni, ndërsa në kuadër të PZHRB ( 2019) në RZHQ janë punësuar 164 persona. Në v.2019 kemi 13 të punësuar më

pak se në v.2018 dhe kemi dallime mjaft të thesksuara të të punësuarve sipas disa Loteve. Në v. 2018 në L1 kanë qenë 28 të punësuar ndërsa në v.2019 në të njëjtin lot janë punësuar 64 persona, ndërsa në L2 në v.2018 kanë qenë 89 të punësuar ndërsa në v.2019 në të njëjtin lot janë punësuar 29.

*Tabela 3, paraqitja e të gjitha të dhënat lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHQ ( PZHRB,2019)*

| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR, LOT 1 (PZHRB 2019)** | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LOT 1** | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Prishtinë | 129 | 14 | Prodhim | 1 | 41 | 5,000.00 € | 1,192.00 € | 63,619.60 € | 23,312.05 € |
| | | | | Shërbime | 13 | | 58,619.60 € | 22,120.05 € | | |
| | Drenas | 20 | 2 | Prodhim | | 12 | | | 8,382.00 € | 5,588.00 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 8,382.00 € | 5,588.00 € | | |
| | Fushë Kosovë | 22 | 1 | Prodhim | / | 2 | | | 3,500.00 € | 571.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 3,500.00 € | 571.00 € | | |
| | Gracanicë | 23 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Lipjan | 7 | 1 | Prodhim | 1 | 4 | 4,900.00 € | 678.10 € | 4,900.00 € | 678.10 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Obiliq | 10 | 1 | Prodhim | / | 1 | / | / | 4,399.00 € | 550.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 4,399.00 € | 550.00 € | | |
| | Podujevë | 21 | 1 | Prodhim | / | 2 | / | / | 5,000.00 € | 984.11 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 5,000.00 € | 984.11 € | | |
| | Shtime | 2 | 1 | Prodhim | 1 | 2 | 4,900.00 € | 587.00 € | 4,900.00 € | 587.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 1)** | | **234** | **21** | | **21** | **64** | **94,700.60 €** | **32,270.26 €** | **94,700.60 €** | **32,270.26 €** |

| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR, LOT 2 (PZHRB 2019)** | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LOT 2** | **Komuna** | **Nr. i përgjithshëm I** | **Numri I biznes** | **Sektorët** | **Nr. I projekteve** | **Numri I të** | **Vlera e financuar nga** | **Shuma e Bashkëfina** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** |

| | përfitu ese | aplikime ve (2019) | eve përfitu ese (2019) | përfit ues | sipas sektor ëve | punsu arve | MZHR (€) | ncimit nga bizneset | Tot. MZHR(2 019) | Bashkëfin ancimi nga Bizneset (2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Prishtin ë | 63 | 8 | Prodh im | 2 | 29 | 21,500.0 0 € | 12,500.00 € | 106,100. 00 € | 34,448.33 € |
| | | | | Shërbi me | 6 | | 84,600.0 0 € | 21,948.33 € | | |
| | Drenas | 2 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Fushë Kosovë | 4 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Graca nicë | 1 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Lipjan | 5 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Obiliq | 1 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Poduje vë | 5 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Shtime | 2 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 2)** | | **83** | **8** | | **8** | **29** | **106,100 .00 €** | **34,448.33 €** | **106,100 .00 €** | **34,448.33 €** |
| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR, LOT 3 (PZHRB 2019)** | | | | | | | | | | |
| **LO T 3** | **Komun a** | **Nr. i përgjithë shëm I** | **Numri I biznes** | **Sektor ët** | **Nr. I projekt eve** | **Numri I të** | **Vlera e financu ar nga** | **Shuma e Bashkëfina** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |

| | përfitu ese | aplikime ve (2019) | eve përfitu ese (2019) | përfit ues | sipas sektor ëve | punsu arve | MZHR (€) | ncimit nga bizneset | Tot. MZHR(2 019) | Bashkëfin ancimi nga Bizneset (2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Prishtin ë | 140 | 8 | Prodh im | 1 | 30 | 25,000.0 0 € | 8,800.00 € | 171,505. 61 € | 54,877.49 € |
| | | | | Shërbi me | 7 | | 146,505. 61 € | 46,077.49 € | | |
| | Drenas | 25 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Fushë Kosovë | 19 | 1 | Prodh im | 1 | 11 | 24,500.0 0 € | 16,000.00 € | 24,500.0 0 € | 16,000.00 € |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Graca nicë | 13 | 2 | Prodh im | 1 | 9 | 25,000.0 0 € | 4,500.00 € | 46,600.0 0 € | 7,600.00 € |
| | | | | Shërbi me | 1 | | 21,600.0 0 € | 3,100.00 € | | |
| | Lipjan | 15 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Obiliq | 5 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| | Poduje vë | 26 | 3 | Prodh im | 1 | 21 | 25,000.0 0 € | 5,000.00 € | 75,000.0 0 € | 15,000.00 € |
| | | | | Shërbi me | 2 | | 50,000.0 0 € | 10,000.00 € | | |
| | Shtime | 6 | 0 | Prodh im | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbi me | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 3)** | | **249** | **14** | | **14** | **71** | **317,605 .61 €** | **93,477.49 €** | **317,605 .61 €** | **93,477.49 €** |

*Tabela 4, paraqitha e përgjithëshme e investimeve për rajonin zhvillimor Qendër (Lot1, Lot2, Lot3):*

| RAJONI SOCIO-EKONOMI | Lot1,Lot2,Lo t3 | Nr. i përgjithëshë m I | Numri I biznesev e | Numri I të | Vlera e financuar | Shuma e Bashkëfinanci | Tot i financimit dhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|

| K QENDËR | | aplikimeve (2019) | përfitues e (2019) | punsuarv e | nga MZHR (€) | mit nga bizneset | bashkëfinanci mit ( 2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LOT 1 | 235 | 21 | 64 | 94,700.60 € | 32,270.26 € | 126,970.86 € |
| | LOT 2 | 83 | 8 | 29 | 106,100.00 € | 34,448.33 € | 140,548.33 € |
| | LOT 3 | 249 | 14 | 71 | 317,605.61 € | 93,477.49 € | 411,083.10 € |
| | **Gjithësej :** | **567** | **43** | **164** | **518,406.21 €** | **160,196.08 €** | **678,602.29 €** |

PZHRB (2019) ka realizuar në total shumën e investime në rajonin zhvillimor Qendër në vlerën prej 518,406.21€, me një numër të përgjithëshëm prej 43 projketeve nga totali i aplikuesve prej 567.Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve të projekteve është pranuar në L3 me një numër prej 249 aplikuesve, ndërsa në këtë Lot kanë fituar 14 projekte në kuadër të PZHRB ( 2019).Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 2, ku kanë aplikuar vetëm 83 aplikues, nga këta 8 projekte fituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në rajonin zhvillimor Qendër është 160,196.08 që nënkupton që në RZHQ sëbashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithëshme prej 678,602.29€.

Në rajonin zhvillimor Qendër janë punësuar në total 164 persona, ku numri më i madh i të punsuarve është realizuar në kuadër të Lot 3 dhe Lot 1.

## IV. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Jug

Rajoni zhvillimor Jug përshin tetë (6) Komuna: (Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë, Dragash dhe Mamushë).

Nga tre (3) programet (MZHR,MIN dhe MTI), në rajonin zhvillimor Jug, janë përkrahë:

- 39 ( tridhjetë e nëntë) biznese nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2019 (PZHRB 2019 – MZHR), në vlërë prej 475,781.08 € ;
- 5 ( pesë ) NMVM nga Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI në vlerë 120,000.00€
- 3 (tre ) biznese nga programi për përkrahjen e bizneseve fillestare nga MIN në Rajonin Zhvillimor Jug në vlerën 26,325.00 €

Nëse krahasojmë Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018 (PZHRB 2018 – MZHR) me PZHRB (2019), shohim se numri i projekteve të financuara nga MZHR gjatë vitit 2019 është rritur për 8 projekte më shumë, gjë që nënkupton që në vitin 2018 MZHR ka mbështetur në total 31 projekte , ndërsa në v.2019 u mbështeten (39) projekte. Nëse e analizojmë shumën totale të financimit PZHRB 2018 shohim se MZHR ka financuar një vlerën prej 304,349.20 €,ndërsa në v.2019 vlera e financimit nga MZHR është 475,781.08 € €. Nga vlerat e sipër cekura shohim se MZHR ka rritur vlerën e financimit në rajonin zhvillimor Jug për 171,431.88 € më shumë.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2019) në rajonin zhvillimor Jug janë pranuar 297 aplikacione në tre (3) Lotet ( 1,2,3) nga gjashtë (6) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 297 , në kategrinë:

- Në Lot 1 janë pranuar 104 aplikacione
- Në Lot 2 janë pranuar 28 aplikacione
- Në Lot 3 janë pranuar 165 aplikacione

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHJ sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- <u>Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare)</u> Nga 2,000 € deri në 5,000 €
  - 19 projekte në vlerë 80,581.08€
- <u>Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet)</u> Nga 5,000 € deri në 15,000 €;
  - 7 projekte në vlerë 101,800.00 €
- <u>Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet)</u> Nga 15,000 € - 25,000 €.
  - 13 projekte në vlerë 293,400.00 €

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2019) në RZHJ

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje €të reja/ fillestare) – 22,143.95 €
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) – 37,063.60 €
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) – 113,095.48 €

Totali i bashkëfinancimit për 3 (tre ) lotet në Rajonin Zhvillimor Jug është 172,303.03 €

### 4.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019), rë rajonin zhvillimor Jug , sektori më i financuar është prodhimime një numër të projekteve prej 22 ( njëzet e dy) duke viju me shërbimet ku janë financuar gjithësejt 17 ( shtatëmbëdhjetë) projekte.

Punësimi nëper Lote në RZHJ sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- LOT 1 – Janë 49 të punësuar:
- LOT 2 – Janë 49 të punësuar:
- LOT 3 – Janë 79 të punësuar:

Në total për v.2018 në kuadër të PZHRB ( 2018) janë punësuar 96 persona duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni, ndërsa në kuadër të PZHRB ( 2019) në RZHJ janë 177 të punësuar. Në v.2019 kemi 81 të punësuar më shumë se në v.2018 dhe dallimet më të mëdha në punësim janë në Lot 3 dhe

Lot1.Vlen të theksohet Lot 3 ku kemi rritje të dyfishuar të të punësuarve në v. 2019 ( 79 të punësuar ) ndërsa në v. 2018 ( 32 të punësuar) .

*Tabelën 5, paraqitja të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHJ (PZHRB 2019)*

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG, LOT 1 (PZHRB 2019) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LOT 1** | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Prizren | 52 | 12 | Prodhim | 5 | 29 | 25,000.00 € | 8,740.00 € | 53,051.55 € | 15,201.00 € |
| | | | | Shërbime | 7 | | 28,051.55 € | 6,461.00 € | | |
| | Dragash | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Malishevë | 17 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Mamushë | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Rahovec | 13 | 1 | Prodhim | 1 | 2 | 4,900.00 € | 1,298.00 € | 4,900.00 € | 1,298.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Suhareke | 20 | 6 | Prodhim | 3 | 18 | 10,153.00 € | 1,782.95 € | 22,629.53 € | 5,644.95 € |
| | | | | Shërbime | 3 | | 12,476.53 € | 3,862.00 € | | |
| **Gjithësej: ( LOT 1)** | | **104** | **19** | | **19** | **49** | **80,581.08 €** | **22,143.95 €** | **80,581.08 €** | **22,143.95 €** |

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG, LOT 2 (PZHRB 2019) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LOT 2** | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Prizren | 16 | 6 | Prodhim | 3 | 39 | 44,000.00 € | 17,100.00 € | 86,800.00 € | 27,152.00 € |
| | | | | Shërbime | 3 | | 42,800.00 € | 10,052.00 € | | |
| | Dragash | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Malishevë | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Mamushë | 1 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Rahovec | 5 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Suhareke | 4 | 1 | Prodhim | 1 | 10 | 15,000.00 € | 9,911.60 € | 15,000.00 € | 9,911.60 € |
| | | | | Shërbime | | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 2)** | | **28** | **7** | | **7** | **49** | **101,800.00 €** | **37,063.60 €** | **101,800.00 €** | **37,063.60 €** |

**RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG, LOT 3 (PZHRB 2019)**

| LOT 3 | Komuna përfituese | Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019) | Numri I bizneseve përfituese (2019) | Sektorët përfitues | Nr. I projekteve sipas sektorëve | Numri I të punsuarve | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Tot. MZHR(2019) | Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019) |
| | Prizren | 69 | 6 | Prodhim | 4 | 27 | 86,500.00 € | 32,360.00 € | 136,480.00 € | 50,371.00 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 49,980.00 € | 18,011.00 € | | |
| | Dragash | 9 | 1 | Prodhim | / | 3 | | | 20,000.00 € | 6,300.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 20,000.00 € | 6,300.00 € | | |
| | Malishevë | 19 | 1 | Prodhim | 1 | 5 | 25,000.00 € | 8,964.48 € | 25,000.00 € | 8,964.48 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Mamushë | 5 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | | | / | / | | |
| | Rahovec | 28 | 2 | Prodhim | 2 | 9 | 44,000.00 € | 17,730.00 € | 44,000.00 € | 17,730.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | | | | |
| | Suhareke | 35 | 3 | Prodhim | 2 | 35 | 49,800.00 € | 25,200.00 € | 67,920.00 € | 29,730.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 18,120.00 € | 4,530.00 € | | |
| | | | | Tregti | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 3)** | | **165** | **13** | | **13** | **79** | **293,400.00 €** | **113,095.48 €** | **293,400.00 €** | **113,095.48 €** |

*Tabela 6, paraqitja e përgjithëshme e investimeve për rajonin zhvillimor Jug (Lot1, Lot2, Lot3):*

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG | Lot1,Lot2,Lot3 | Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019) | Numri I bizneseve përfituese (2019) | Numri I të punsuarve | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LOT 1 | 104 | 19 | 49 | 80,581.08 € | 22,143.95 € | **102,725.03 €** |
| | LOT 2 | 28 | 7 | 49 | 101,800.00 € | 37,063.60 € | **138,863.60 €** |
| | LOT 3 | 165 | 13 | 79 | 293,400.00 € | 113,095.48 € | **406,495.48 €** |
| | **Gjithësej :** | **297** | **39** | **177** | **475,781.08 €** | **172,303.03 €** | **648,084.11 €** |

PZHRB (2019) ka realizuar në total shumën  e investime në Rajonin Zhvillimor Jug  në vlerën prej  475,781.08 €, me një numër të përgjithëshëm prej 39 projketeve nga totali i aplikuesve prej 297. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve të projekteve është pranuar në L3 me një numër prej 165 aplikuesve, ndërsa kanë fituar 13 projekte në kuadër të PZHRB ( 2019).Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 2, ku kanë aplikuar vetëm 28 aplikues, nga këta 7 projekte fituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në Rajonin Zhvillimor Jug është 172,303.03 që nënkupton që në  RZHJ sëbashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithëshme prej 648,084.11€.

Në Rajonin Zhvillimor Jug janë punësuar në total 177 persona, ku numri më i madh i të punsuarve është realizuar në kuadër të Lot 3,ndërsa Lo1 dhe Lot 2 kanë të punësuar me  numër të barabartë .

## V. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim

Rajoni zhvillimor Perëndim  përfshin tetë (6) Komuna: (Pejë, Klinë, Istog, Junik, Deçan dhe Gjakovë)

Nga tre (3) programet (MZHR,MIN dhe MTI), në Rajonin Zhvillimor Perëndim, janë përkrahë:

- 40  ( katërdhjetë) biznese nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2019 (PZHRB 2019 – MZHR), në vlërë prej 460,775.05€ ;
- 2 ( dy ) NMVM nga Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI në vlerë 60,000.00€
- 12 ( dymbëdhkjetë) biznese nga  programi për përkrahjen e bizneseve fillestare nga MIN  në Rajonin Zhvillimor Perëndim në vlerën 103,639.50 €

Nëse krahasojmë  Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018 (PZHRB 2018 – MZHR) me PZHRB (2019), shohim se numri i projekteve të financuara nga MZHR gjatë vitit 2019 është rritur për 9 projekte më shumë, gjë që nënkupton që në vitin 2018 MZHR ka mbështetur në total 31 projekte , ndërsa në v.2019 janë financuar 40 projekte. Nëse e analizojmë shumën totale të financimit PZHRB 2018 shohim se MZHR ka financuar

vlerën prej 303,163.50 €,ndërsa në v.2019 vlera e financimit nga MZHR është 460,775.05 €. Nga vlerat e sipër cekura shohim se MZHR ka rritur vlerën e financimit në rajonin zhvillimor Perëndim për 157,611.55 € më shumë.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2019) në Rajonin Zhvillimor Perëndim janë pranuar 291 aplikacione në tre (3) Lotet ( 1,2,3) nga gjashtë (6) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 291 , në kategrinë:

- Në Lot 1 janë pranuar 121 aplikacione
- Në Lot 2 janë pranuar 38 aplikacione
- Në Lot 3 janë pranuar 132 aplikacione

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHP sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) Nga 2,000 € deri në 5,000 €
    - 20 projekte në vlerë 86,686.54 €
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) Nga 5,000 € deri në 15,000 €;
    - 8 projekte në vlerë 108,520.00 €
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) Nga 15,000 € - 25,000 €
    - 12 projekte në vlerë 265,568.51 €

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2019) në RZHP

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje €të reja/ fillestare) – 21,367.11 €
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) – 29,883.00 €
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) – 84,178.69 €

Totali i bashkëfinancimit për 3 (tre ) lotet në Rajonin Zhvillimor Perëndim është 135,428.80 €

### 5.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019), rë rajonin zhvillimor Perëndim , sektori më i financuar është prodhimi me një numër të projekteve prej 22 ( njëzet e dy) duke viju me shërbimet ku janë financuar gjithësejt 18 ( tetëmbëdhjetë) projekte.

Punësimi nëper Lote në RZHP sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- LOT 1 – Janë 55 të punësuar:
- LOT 2 – Janë 27 të punësuar:

- LOT 3 – Janë 68 të punësuar:

Në total për v.2018 në kuadër të PZHRB ( 2018) janë punësuar 100 persona duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni, ndërsa në kuadër të PZHRB ( 2019) në RZHP janë 150 të punësuar. Në v.2019 kemi 50 të punësuar më shumë se në v.2018 dhe dallimet më të mëdha në punësim janë në Lot 3 dhe Lot 1. Vlen të theksohet Lot 3 ku kemi rritje të të punësuarve në v. 2019 ( 68 të punësuar ) ndërsa në v. 2018 ( 43 të punësuar) si dhe poashtu rritje të theksuar në L1, 2019 janë (55 të punësuar ) ndërsa 2018 kanë qenë (37) të punësuar.

*Tabela 7, paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHP (PZHRB 2019)*

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM, LOT 1 (PZHRB 2019) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LOT 1 | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Pejë | 32 | 7 | Prodhim | 2 | 19 | 8,580.00 € | 1,230.00 € | 29,873.09 € | 8,770.41 € |
| | | | | Shërbime | 5 | | 21,293.09 € | 7,540.41 € | | |
| | Istog | 17 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Deçan | 21 | 3 | Prodhim | 1 | 8 | 2,437.65 € | 1,044.70 € | 9,113.45 € | 2,668.70 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 6,675.80 € | 1,624.00 € | | |
| | Junik | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Klinë | 19 | 1 | Prodhim | / | 1 | | | 5,000.00 € | 565.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 5,000.00 € | 565.00 € | | |
| | Gjakovë | 32 | 9 | Prodhim | 3 | 27 | 15,000.00 € | 1,922.00 € | 42,700.00 € | 9,363.00 € |
| | | | | Shërbime | 6 | | 27,700.00 € | 7,441.00 € | | |
| **Gjithësej: ( LOT 1)** | | **121** | **20** | | **20** | **55** | **86,686.54 €** | **21,367.11 €** | **86,686.54 €** | **21,367.11 €** |

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM, LOT 2 (PZHRB 2019) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LOT 2 | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |

| | Komuna përfituese | Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019) | Numri I bizneseve përfituese (2019) | Sektorët përfitues | Nr. I projekteve sipas sektorëve | Numri I të punsuarve | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot. MZHR(2019) | Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pejë | 14 | 4 | Prodhim | 3 | 14 | 41,000.00 € | 4,753.00 € | 54,000.00 € | 6,503.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 13,000.00 € | 1,750.00 € | | |
| | Istog | 6 | 1 | Prodhim | 1 | 2 | 14,800.00 € | 4,200.00 € | 14,800.00 € | 4,200.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Deçan | 5 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Junik | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | / | / |
| | Klinë | 2 | 2 | Prodhim | 2 | 7 | 24,720.00 € | 11,480.00 € | 24,720.00 € | 11,480.00 € |
| | | | | Shërbime | | | | | | |
| | Gjakovë | 11 | 1 | Prodhim | 1 | 4 | 15,000.00 € | 7,700.00 € | 15,000.00 € | 7,700.00 € |
| | | | | Shërbime | | | | | | |
| **Gjithësej: ( LOT 2)** | | | | | **8** | | **108,520.00 €** | **29,883.00 €** | **108,520.00 €** | **29,883.00 €** |
| | | 38 | 8 | | | 27 | | | | |

RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM, LOT 3 (PZHRB 2019)

| LOT 3 | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Pejë | 39 | 2 | Prodhim | 2 | 12 | 45,700.00 € | 15,700.00 € | 45,700.00 € | 15,700.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Istog | 14 | 0 | Prodhim | / | | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Deçan | 14 | 6 | Prodhim | 4 | 22 | 83,257.25 € | 23,210.25 € | 121,101.01 € | 36,046.19 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 37,843.76 € | 12,835.94 € | | |
| | Junik | 2 | 0 | Prodhim | / | | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Klinë | 17 | 1 | Prodhim | / | 4 | / | / | 25,000.00 € | 3,000.00 € |
| | | | | Shërbime | 4 | | 25,000.00 € | 3,000.00 € | | |
| | Gjakovë | 46 | 3 | Prodhim | 3 | 30 | 73,767.50 € | 29,432.50 € | 73,767.50 € | 29,432.50 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 3)** | | **132** | **12** | / | **12** | **68** | **265,568.51 €** | **84,178.69 €** | **265,568.51 €** | **84,178.69 €** |
| | | | | / | | | | | | |
| | | | | / | | | | | | |

*Tabela 8, parqitja e përgjithëshme e investimeve për rajonin zhvillimor Perëndim (Lot1, Lot2, Lot3):*

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERENDIM | Lot1,Lot2,Lot3 | Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019) | Numri I biznesev e përfitues e (2019) | Numri I të punsuarv e | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LOT 1 | 121 | 20 | 55 | 86,686.54 € | 21,367.11 € | 108,053.65 € |
| | LOT 2 | 38 | 8 | 27 | 108,520.00 € | 29,883.00 € | 138,403.00 € |
| | LOT 3 | 132 | 12 | 68 | 265,568.51 € | 84,178.69 € | 349,747.20 € |
| | **Gjithësej :** | **291** | **40** | **150** | **460,775.05 €** | **135,428.80 €** | **596,203.85 €** |

PZHRB (2019) ka realizuar në total shumën e investime në rajonin zhvillimor Perëndim në vlerën prej 460,775.05 €, me një numër të përgjithëshëm prej 40 projketeve nga totali i aplikuesve prej 291. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve të projekteve është pranuar në L3 me një numër prej 132 aplikuesve, ndërsa kanë fituar 12 projekte në kuadër të PZHRB ( 2019).Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 2, ku kanë aplikuar vetëm 38 aplikues, nga këta 8 projekte fituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në rajonin zhvillimor Perëndim është 135,428.80 € që nënkupton që në RZHP sëbashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithëshme prej 596,203.85€.

Në rajonin zhvillimor Perëndim janë punësuar në total 150 persona, ku numri më i madh i të punsuarve është realizuar në kuadër të Lot 3 dhe Lot 2 .

## VI. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Veri

Rajoni Zhvillimor Veri përshin shtatë (7) komuna: (Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok,Vushtrri dhe Skenderaj)

Nga tre (3) programet (MZHR,MIN dhe MTI), në Rajonin Zhvillimor Veri, janë përkrahë:

- 37 ( tridhjetë e shtatë) biznese nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2019 (PZHRB 2019 – MZHR), në vlërë prej 449,517.24 € ;
- 3 ( tre ) NMVM nga Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI në vlerë 89,000.00€
- 7 ( shtatë) biznese nga programi për përkrahjen e bizneseve fillestare nga MIN në Rajonin Zhvillimor Veri në vlerën 63,000.00 €

Nëse krahasojmë Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018 (PZHRB 2018 – MZHR) me PZHRB (2019), shohim se numri i projekteve të financuara nga MZHR gjatë vitit 2019 është rritur për 13 projekte më shumë, gjë që nënkupton që në vitin 2018 MZHR ka mbështetur në total 24 projekte , ndërsa në v.2019,janë financuar 37 projekte. Nëse e analizojmë shumën totale të financimit PZHRB 2018 shohim se MZHR ka

financuar vlerën prej 208,112.50€ €, ndërsa në v.2019 vlera e financimit nga MZHR është 449,517.24 € . Nga vlerat e sipër cekura shohim se MZHR ka dyfishuar vlerën e financimit në rajonin zhvillimor Veri për 241,404.74€ më shumë.

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHV sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) Nga 2,000 € deri në 5,000 €
    - 17 projekte në vlerë 72,925.50€
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) Nga 5,000 € deri në 15,000 €
    - 7 projekte në vlerë 84,747.74€
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) Nga 15,000 € - 25,000 €
    - 13 projekte në vlerë 291,844.00€

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2019) në Rajonin Zhvillimor Veri janë pranuar (240) aplikacione në tre (3) Lotet ( 1,2,3) nga gjashtë (6) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 240 , në kategrinë:

- Në Lot 1 janë pranuar 130 aplikacione
- Në Lot 2 janë pranuar 27 aplikacione
- Në Lot 3 janë pranuar 83 aplikacione

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2019) në RZHV

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) – 12,392.39 €
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) – 22,844.31 €
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) – 76,67.99€

Totali i bashkëfinancimit për 3 (tre ) lotet në Rajonin Zhvillimor Veri është 111,404.69 €

### 6.1 Sektorët përfitues dhe xhenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019), rë Rajonin Zhvillimor Veri, sektori më i financuar është prodhimi me një numër të projekteve prej 19 ( nëntëmbëdhjetë )duke viju me shërbimet ku janë financuar gjithësejt 18 ( tetëmbëdhjetë) projekte. Në Rajonin Zhvillimor Veri vërejmë se dy sektorët si prodhimi dhe shërbimet kanë numër gati të barbartë të projekteve të financuara.

Punësimi nëper lote në RZHV sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- LOT 1 – Janë 36 të punësuar:
- LOT 2 – Janë 24 të punësuar:
- LOT 3 – Janë 48 të punësuar:

Në total për v.2018 në kuadër të PZHRB ( 2018) janë punësuar 87 persona duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni, ndërsa në kuadër të PZHRB ( 2019) në RZHV janë 108 të punësuar. Në v.2019 kemi 21 të punësuar më shumë se në v.2018 dhe dallimet më të mëdha në punësim janë në Lot 2 dhe Lot 3. Vlen të theksohet Lot 2 ku kemi dyfishim të të punësuarve në v. 2019 ( 24 të punësuar ) ndërsa në v. 2018 ( 12 të punësuar) si dhe poashtu rritje të theksuar në L3 ku në 2019 janë (48 të punësuar ), ndërsa 2018 kanë qenë (38 të punësuar).

*Tabela 9 ,paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHV (PZHRB 2019)*

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI, LOT 1 (PZHRB 2019) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LOT 1 | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Mitrovicë | 51 | 7 | Prodhim | 1 | 14 | 2,057.51 € | 363.09 € | 28,411.91 € | 4,313.09 € |
| | | | | Shërbime | 6 | | 26,354.40 € | 3,950.00 € | | |
| | Skënderaj | 16 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Vushtrri | 20 | 5 | Prodhim | 4 | 13 | 18,810.59 € | 2,689.30 € | 22,713.59 € | 3,289.30 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 3,903.00 € | 600.00 € | | |
| | M.Veriore | 15 | 0 | Prodhim | 2 | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | 1 | | / | / | | |
| | Leposaviq | 18 | 3 | Prodhim | / | 7 | 10,000.00 € | 2,490.00 € | 14,000.00 € | 3,390.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | 4,000.00 € | 900.00 € | | |
| | Zveqan | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Zubin Potok | 8 | 2 | Prodhim | / | 2 | / | / | 7,800.00 € | 1,400.00 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 7,800.00 € | 1,400.00 € | | |
| **Gjithësej: ( LOT 1)** | | **130** | **17** | | **17** | **36** | **72,925.50 €** | **12,392.39 €** | **72,925.50 €** | **12,392.39 €** |
| RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI, LOT 2 (PZHRB 2019) | | | | | | | | | | |

| LOT 2 | Komuna përfituese | Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019) | Numri I bizneseve përfituese (2019) | Sektorët përfitues | Nr. I projekteve sipas sektorëve | Numri I të punsuarve | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Tot. MZHR(2019) | Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019) |
| | Mitrovicë | 13 | 2 | Prodhim | | 4 | / | / | 24,910.00 € | 2,782.80 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 24,910.00 € | 2,782.80 € | | |
| | Skënderaj | 6 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Vushtrri | 3 | 4 | Prodhim | 3 | 18 | 41,360.00 € | 16,690.00 € | 47,674.74 € | 17,391.64 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 6,314.74 € | 701.64 € | | |
| | | | | Tregti | / | | / | / | | |
| | M.Veriore | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Leposaviq | 4 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Zveqan | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Zubin Potok | 1 | 1 | Prodhim | 1 | 2 | 12,163.00 € | 2,669.87 € | 12,163.00 € | 2,669.87 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 2)** | | **27** | **7** | | **7** | **24** | **84,747.74 €** | **22,844.31 €** | **84,747.74 €** | **22,844.31 €** |

RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI, LOT 3 (PZHRB 2019)

| LOT 3 | Komuna përfituese | Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019) | Numri I bizneseve përfituese (2019) | Sektorët përfitues | Nr. I projekteve sipas sektorëve | Numri I të punsuarve | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Tot. MZHR(2019) | Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019) |
| | Mitrovicë | 42 | 9 | Prodhim | 5 | 30 | 116,850.00 € | 38,250.00 € | 203,290.00 € | 50,267.97 € |
| | | | | Shërbime | 4 | | 86,440.00 € | 12,017.97 € | | |
| | Skënderaj | 8 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Vushtrri | 20 | 4 | Prodhim | 3 | 18 | 66,054.00 € | 23,400.00 € | 88,554.00 € | 25,900.02 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 22,500.00 € | 2,500.02 € | | |
| | M.Veriore | 3 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Leposaviq | 9 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Zveqan | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Zubin Potok | 1 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| Gjithësej: ( LOT 3) | | **83** | | | **13** | **48** | **291,844.00 €** | **76,167.99 €** | **291,844.00 €** | **76,167.99 €** |
| | | | 13 | | | | | | | |

*Tabela 10 ,paraqitja e investimeve për rajonin zhvillimor Veri (Lot1, Lot2, Lot3):*

| RAJONI SOCIO-EKONOMIK VERI | Lot1,Lot2,Lot3 | Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019) | Numri I biznesev e përfitues e (2019) | Numri I të punsuarve | Vlera e financuar nga MZHR (€) | Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset | Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LOT 1 | 130 | 17 | 36 | 72,925.50 € | 12,392.39 € | 85,317.89 € |
| | LOT 2 | 27 | 7 | 24 | 84,747.74 € | 22,844.31 € | 107,592.05 € |
| | LOT 3 | 83 | 13 | 48 | 291,844.00 € | 76,167.99 € | 368,011.99 € |
| | **Gjithësej :** | **240** | **37** | **108** | **449,517.24 €** | **111,404.69 €** | **560,921.93 €** |

PZHRB (2019) ka realizuar në total shumën e investime në Rajonin Zhvillimor Veri në vlerën prej 449,517.24 €, me një numër të përgjithëshëm prej 37 projketeve nga totali i aplikuesve prej 240. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve të projekteve është pranuar në L1 me një numër prej 130 aplikuesve, ndërsa kanë fituar 17 projekte në kuadër të PZHRB ( 2019).Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 2, ku kanë aplikuar vetëm 27 aplikues, nga këta (7) projekte fituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në Rajonin Zhvillimor Veri është 111,404.69 € që nënkupton që në RZHV sëbashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithëshme prej 560,921.93€.

Në rajonin zhvillimor Veri janë punësuar në total 108 persona, ku numri më i madh i të punsuarve është realizuar në kuadër të Lot 3 dhe Lot 2 .

## VII. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Lindje

Në rajonin socio-ekonomik Lindje I cili përshin njëmbëdhjetë (11) Komuna: (Ferizaj, Gjilan, Han I Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Shtërpce, Viti, Kllokot, Ranillug, Kamenicë dhe Partesh).

Nga tre (3) programet (MZHR,MIN dhe MTI), në rajonin zhvillimor Lindje, janë përkrahë:

- 42 (katërdhjetë e dy) biznese nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2019 (PZHRB 2019 – MZHR), në vlerë prej 483,289.87€ ;
- 2 ( dy ) NMVM nga Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 nga MTI në vlerë 70,000.00€
- 6 (gjashtë) biznese nga programi për përkrahjen e bizneseve fillestare nga MIN në Rajonin Zhvillimor Lindje në vlerën 51,038.10 €

Nëse krahasojmë Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018 (PZHRB 2018 – MZHR) me PZHRB (2019), shohim se numri i projekteve të financuara nga MZHR gjatë vitit 2019 është rritur për 13 projekte më shumë, gjë që nënkupton që në vitin 2018 MZHR ka mbështetur në total 29 projekte , ndërsa në v.2019,janë financuar 42 projekte. Nëse e analizojmë shumën totale të financimit PZHRB 2018 shohim se MZHR ka financuar vlerën prej 253,969.00 €, ndërsa në v.2019 vlera e financimit nga MZHR është 483,289.87€. Nga vlerat e sipër cekura shohim se MZHR poashtu gati ka dyfishuar vlerën e financimit edhe në rajonin zhvillimor Lindje për 229,320.87 € më shumë.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2019) në Rajonin Zhvillimor Lindje janë pranuar (291) aplikacione në tre (3) Lotet ( 1,2,3) nga gjashtë (6) Komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 291 , në kategrinë:

- Në Lot 1 janë pranuar 112 aplikacione
- Në Lot 2 janë pranuar 37 aplikacione
- Në Lot 3 janë pranuar 142 aplikacione

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHL sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) Nga 2,000 € deri në 5,000 €
    - 21 projekte në vlerë 91,953.53€
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) Nga 5,000 € deri në 15,000 €;
    - 9 projekte në vlerë 118,756.34€
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) Nga 15,000 € - 25,000 €
    - 12 projekte në vlerë 272,580.00€

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2019) në RZHV

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) – 22,900.09 €
- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) – 33,821.80 €
- Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) – 71,483.30 €

Totali i bashkëfinancimit për 3 (tre ) lotet në rajonin zhvillimor veri është 128,205.19 €

### 7.1 Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2019), rë rajonin zhvillimor lindje, sektori më i financuar janë shërbimet me një numër të projekteve prej 22 ( njëzet e dy ), duke viju me prodhimin ku janë financuar gjithësejt 20 ( njëzet) projekte. Në rajonin zhvillimor Lindje vërejmë se dy sektorët si prodhimi dhe shërbimet kanë numër gati të barbartë të projekteve të financuara.

Punësimi nëper Lote në RZHL sipas PZHRB (2019) është si vijon:

- LOT 1 – Janë 46 të punësuar:
- LOT 2 – Janë 41 të punësuar:
- LOT 3 – Janë 65 të punësuar:

Në total për v.2018 në kuadër të PZHRB ( 2018) janë punësuar 101 persona duke përfshirë (Lot1, Lot2 dhe Lot 3) në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni, ndërsa në kuadër të PZHRB ( 2019) në RZHL janë 152 të punësuar. Në v.2019 kemi 51 të punësuar më shumë se në v.2018 dhe dallimet më të mëdha në punësim janë në Lot 2 .Vlen të theksohet Lot 2 ku kemi trefishim të të punësuarve në v. 2019 ( 41 të punësuar ) ndërsa në v. 2018 ( 16 të punësuar) .

*Tabela 11, paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHL (PZHRB 2019)*

| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE, LOT 1 (PZHRB 2019)** | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LOT 1** | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Gjilan | 32 | 5 | Prodhim | 1 | 9 | 5,000.00 € | 3,100.00 € | 22,755.00 € | 8,280.00 € |
| | | | | Shërbime | 4 | | 17,755.00 € | 5,180.00 € | | |
| | Novobërdë | 4 | 1 | Prodhim | / | 3 | / | / | 5,000.00 € | 890.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 5,000.00 € | 890.00 € | | |
| | | | | Tregti | / | | / | / | | |
| | Kamenicë | 8 | 3 | Prodhim | / | 5 | / | / | 10,758.33 € | 1,564.59 € |
| | | | | Shërbime | 3 | | 10,758.33 € | 1,564.59 € | | |
| | Ferizaj | 36 | 5 | Prodhim | / | 19 | / | / | 24,200.00 € | 5,062.00 € |
| | | | | Shërbime | 5 | | 24,200.00 € | 5,062.00 € | | |
| | Kaçanik | 2 | 1 | Prodhim | / | 3 | / | / | 4,490.00 € | 671.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 4,490.00 € | 671.00 € | | |
| | Shtërpcë | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Viti | 12 | 1 | Prodhim | 1 | 1 | / | / | 5,000.00 € | 1,590.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | 5,000.00 € | 1,590.00 € | | |
| | Hani Elezit | 5 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Kllokot | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Ranillugë | 4 | 2 | Prodhim | 1 | 3 | 5,000.00 € | 1,500.00 € | 7,700.00 € | 2,192.50 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 2,700.00 € | 692.50 € | | |
| | Partesh | 5 | 3 | Prodhim | 3 | 3 | 12,050.20 € | 2,650.00 € | 12,050.20 € | 2,650.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| **Gjithësej: ( LOT 1)** | | **112** | **21** | | **21** | **46** | **91,953.53 €** | **22,900.09 €** | **91,953.53 €** | **22,900.09 €** |
| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE, LOT 2 (PZHRB 2019)** | | | | | | | | | | |
| **LOT 2** | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Gjilan | 15 | 2 | Prodhim | / | 19 | / | / | 25,000.00 € | 9,460.00 € |
| | | | | Shërbime | 2 | | 25,000.00 € | 9,460.00 € | | |
| | Novobërdë | 1 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Kamenicë | 3 | 1 | Prodhim | 1 | 3 | | | 13,498.20 € | 1,499.80 € |
| | | | | Shërbime | | | 13,498.20 € | 1,499.80 € | | |
| | Ferizaj | 12 | 5 | Prodhim | 2 | 15 | 26,850.00 € | 12,990.00 € | 68,458.14 € | 19,662.00 € |
| | | | | Shërbime | 3 | | 41,608.14 € | 6,672.00 € | | |
| | Kaçanik | 3 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Shtërpcë | 1 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Viti | 2 | 1 | Prodhim | 1 | 4 | 11,800.00 € | 3,200.00 € | 11,800.00 € | 3,200.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | | | | Tregti | / | | / | / | | |
| | Hani Elezit | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Kllokot | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Ranillugë | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Partesh | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| Gjithësej: ( LOT 2) | | **37** | **9** | | **9** | **41** | **118,756.34 €** | **33,821.80 €** | **118,756.34 €** | **33,821.80 €** |
| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE, LOT 3 (PZHRB 2019)** | | | | | | | | | | |
| **LOT 3** | **Komuna përfituese** | **Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Sektorët përfitues** | **Nr. I projekteve sipas sektorëve** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** | |
| | | | | | | | | | **Tot. MZHR(2019)** | **Bashkëfinancimi nga Bizneset (2019)** |
| | Gjilan | 40 | 1 | Prodhim | / | 2 | / | / | 15,000.00 € | 1,700.00 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 15,000.00 € | 1,700.00 € | | |
| | Novobërdë | 1 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Kamenicë | 8 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | | | | | | |
| | Ferizaj | 70 | 9 | Prodhim | 8 | 58 | 190,580.00 € | 58,080.00 € | 207,580.00 € | 60,933.30 € |
| | | | | Shërbime | 1 | | 17,000.00 € | 2,853.30 € | | |
| | Kaçanik | 5 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Shtërpcë | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | | | | Tregti | / | | / | / | | |
| | Viti | 13 | 2 | Prodhim | 2 | 5 | 50,000.00 € | 8,850.00 € | 50,000.00 € | 8,850.00 € |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Hani Elezit | 1 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Kllokot | 2 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Ranillugë | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | Partesh | 0 | 0 | Prodhim | / | / | / | / | / | / |
| | | | | Shërbime | / | | / | / | | |
| | | **142** | **12** | | **12** | **65** | | **71,483.30 €** | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjithësej: ( LOT 3)** | | | | | | **272,580 .00 €** | | **272,580 .00 €** | **71,483.30 €** |

*Tabela 12, paraqitja e investimeve për rajonin zhvillimor Lindje (Lot1, Lot2, Lot3):*

| **RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE** | **Lot1,Lot2,Lot3** | **Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2019)** | **Numri I bizneseve përfituese (2019)** | **Numri I të punsuarve** | **Vlera e financuar nga MZHR (€)** | **Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset** | **Tot i financimit dhe bashkëfinancimit ( 2019)** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LOT 1 | 112 | 21 | 46 | 91,953.53 € | 22,900.09 € | **114,853.62 €** |
| | LOT 2 | 37 | 9 | 41 | 118,756.34 € | 33,821.80 € | **152,578.14 €** |
| | LOT 3 | 142 | 12 | 65 | 272,580.00 € | 71,483.30 € | **344,063.30 €** |
| | **Gjithësej :** | **291** | **42** | **152** | **483,289.87 €** | **128,205.19 €** | **611,495.06 €** |

PZHRB (2019) ka realizuar në total shumën e investime në rajonin zhvillimor Lindje në vlerën prej 483,289.87 €, me një numër të përgjithëshëm prej 42 projketeve nga totali i aplikuesve prej 291. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve të projekteve është pranuar në L3 me një numër prej 142 aplikuesve, ndërsa kanë fituar 12 projekte në kuadër të PZHRB ( 2019).Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 2, ku kanë aplikuar vetëm 37 aplikues, nga këta 9 projekte fituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në rajonin zhvillimor Lindje është 128,205.19 € që nënkupton që në RZHL sëbashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithëshme prej 611,495.06€.

Në Rajonin Zhvillimor Lindje janë punësuar në total 152 persona, ku numri më i madh i të punsuarve është realizuar në kuadër të Lot 3 dhe Lot 2 .

## VIII. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE

Mëposht janë të paraqitura në formë të grafikonit në përqindje vlerat tabelare të interpretuara edhe në narracion për pesë (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore në Kosovë ( Rajonin Qendër, Rajonin Veri, Rajonin Jug, Rajonin Lindje dhe Rajonin Perëndim) për sa i përket implementimit të PZHRB (2019). Gjithashtu vlerat e financimit të projekteve janë të ndara në Lote (1, 2, 3) për secilin rajon në veçanti me qëllim të një pasqyrimi më të qartë dhe transparent të pesë (5) rajoneve zhvillimore.

## 8.1 Rajoni Zhvillimor Qendër

Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas Loteve në Rajonin Zhvillimor Qendër nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve "Programi I zhvillimit rajonal të balancuar" viti 2019, paraqitet si në grafikonin në vijim:

*Graf 1, shpëndarja e mjeteve sipas lotëve në RZHQ (PZHRB 2019)*




## 8.2 Rajoni Zhvillimor Jug

Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas Loteve në Rajonin Zhvillimor Jug nga MZHR në kuadër të Skemës së Granteve "Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar" viti 2019, paraqitet si në grafikonin në vijim:

*Graf 2, shpëndarja e mjeteve sipas lotëve në RZHJ (PZHRB 2019)*



## 8.4 Rajoni Zhvillimor Perëndim

Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas Loteve në Rajonin Zhvillimor Perëndim nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve "Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar" 2019, paraqitet si në grafikonin në vijim:

*Graf3, shpëndarja e mjeteve sipas lotëve në RZHP (PZHRB 2019)*




## 8.3 Rajoni Zhvillimor Veri

Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas Loteve në Rajonin Zhvillimor Veri nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve "Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar" viti 2019, paraqitet si në grafikonin në vijim:

*Graf 4, shpëndarja e mjeteve sipas lotëve në RZHV (PZHRB 2019)*



## 8.5 Rajoni Zhvillimor Lindje

Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas Loteve në Rajonin Zhvillimor Lindje nga MZHR në kuadër të Skemes së Granteve "Programi I Zhvillimit Rajonal të Balancuar" viti 2019, paraqitet si në grafikonin në vijim:

*Graf 5, shpëndarja e mjeteve sipas lotëve në RZHL (PZHRB 2019)*




## IX .Shuma e përgjithëshme e investimeve në (%) duke përfshi 3 Lotet ( Lot1, Lot2 dhe Lot3) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë

Në grafikonin e mëposhtëm vërejmë një shpërndarje mjaftueshëm të balancuar me diferenca apo disbalance të vogla deri 2% në rajone të caktuara në përgjithësi .Nga grafikoni I mëposhtëm mund të shohim se rajoni Veri ka vlerën më të vogël të financimit prej 449,517.24€ në krahasim me rajonet tjera. Një përqindje e tillë ka rezultuar përshkak të numrit më të vogël të aplikimeve të pranuara nga Rajoni Zhvillimor Veri e cila situatë ka çuar në një konkurueshmëri më të vogël në raport me rajonet tjera socio-ekonomike zhvillimore në Kosovë. Subvencionimi i bizneseve në pesë (5) rajonet socio ekonomike të Kosovës është bërë konform Udhëzuesit administrativ për përmbushjen e kritereve për secilin Lot në veçanti.

*Tabela 13, paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2019)*

| PESË (5) RAJONET SOCIO-EKONOMIKE | VLERA E FINANCIMIT-PZHRB 2019 ( €) | VLERA E BASHKËFINANCIMIT NGA BIZNESET |
|---|---|---|
| Rajoni socio Ekonomik Qendër | 518,406.21 € | 160,196.08 € |
| Rajoni Socio-Ekonomik Jug | 475,781.08 € | 172,303.03 € |
| Rajoni socio- Ekonomik Perëndim | 460,775.05 € | 135,428.80 € |

| | | |
|---|---|---|
| Rajoni Socio-Ekonomik Veri | 449,517.24 € | 111,404.69 € |
| Rajoni Socio –Ekonomik Lindje | 483,289.87 € | 128,205.19 € |
| **GJITHËSEJT:** | **2,387,769.45 €** | **707,537.79 €** |

*Graf 6 , shpëndarja e mjeteve sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2019)*




## X. Shuma e përgjithëshme e bashkëfinancimeve në (%) nga bizneset duke përfshirë tre (3) Lotet ( Lot1, Lot2 dhe Lot3) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë

*Graf 7 , shpëndarja e mjeteve të bashkëfinancimit sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2019)*



## XI. Shuma e përgjithëshme e investimeve në (%) duke përfshirë 3 Lotet ( Lot1, Lot2 dhe Lot3) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë në bazë të përkatësisë etnike.

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar", për vitin 2019 ka mbështetur financiarisht një numër relativisht të madh të projekteve të komunitetve tjera në Kosove ( Serb, Boshnjak, Turq, Rom, Ashkali, Egjiptas dhe Goran ) ,në një përqindje mjaftueshëm të lartë prej 18% ne raport me numrin e përgjithëshëm të komuniteteve në Kosovë.

*Graf 8 , shpëndarja e mjeteve sipas përkatësisë etnike sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2019)*




## XII. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve sipas komuniteteve në rajone zhvillimore

*Tabela 14 , paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve sipas përkatësisë etnike në pesë pesë(5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2019)*

| Pesë (5) rajonet zhvillimore | Përkatësia Etnike | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kosovar | Serb | Boshnjak | Turk | Goran | Rom, Ashakli, Egjiptas |
| QENDËR | 41 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| JUG | 26 | **0** | 11 | 1 | 1 | 0 |
| LINDJE | 35 | 5 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| PERËNDIM | 33 | 0 | 1 | 0 | 0 | 6 |
| VERI | 30 | 6 | 1 | 0 | 0 | 0 |

### XIII. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar", për vitin 2019 ka mbështetur financiarisht 55 (pesëdhjetë e pesë) biznese të udhëhequra nga gratë dhe 146 ( (njëqind e katërdhjetë e gjashtë) biznese të udhëhequra nga burrat

Krahasuar me v.2018 nga gjithësejt 52 projekte të mbështetura nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (2018) , në vitin 2019, MZHR ka financuar 3 (tre)projekte më shumë apo (55) projekte në total të udhëhequra nga gratë në kuadër të kësaj skeme. MZHR është e përkushtuar që të stimulojë gjithnjë e më shumë projekte të tilla .Numri më i madh i projekteve të financuara për gratë është në Rajonin Zhvillimor Qendër , me një numër prej 16 projekteve. Në total kemi 146 projekte të financuara që udhëhiqen nga burrat dhe 55 projekte tjera të udhëhequra nga gratë.

*Graf 9, shpërndarja e projekteve të udhëhequra në baza gjinore në % për pesë(5) rajonet zhvillimore (PZHRB 2019)*




### Shpërndarja tabelare e pesëdhjetë e pesë (55) projekteve të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë

*Tabela 15 , paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve të projekteve të udhëhequra nga gratë në pesë(5) rajone zhvillimore (PZHRB 2019)*

| PESË (5) RAJONET ZHVILLIMORE | NUMRI I PËRGJITHËSHËM I PROJEKTEVE |
|---|---|
| Rajoni socio Ekonomik Qendër | 16 |
| Rajoni Socio-Ekonomik Jug | 12 |
| Rajoni socio- Ekonomik Perëndim | 6 |
| Rajoni Socio-Ekonomik Veri | 11 |
| Rajoni Socio –Ekonomik Lindje | 10 |
| **GJITHËSEJT:** | **55** |

### Paraqitja grafike në % e shpërndarjes së e pesëdhjetë e pesë (55) projekteve të udhëhequra nga grate në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë

*Graf 10 , shpëndarja e mjeteve të projekteve të udhëhequra nga gratë  në pesë(5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2019)*




## XIV. Analizë e pyetësorit të realizuar nga MZHR tek përfituesit e skemes së granteve "Programi për zhvillim rajonal të balancuar " PZHRB për vitet  (2018-2019)

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për të pasqyruar në mënyrë sa më transparente dhe direkte  impaktin që ka skema e granteve"Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar "(PZHRB),ka realizuar një pyetësor me pyetje specifike,i cili është shpërndarë tek një mostër prej rreth dyqind (200) përfituesve të viteve 2018-2019.MZHR ka  pranuar mbi njëqind (100) pyetësor më përgjigje brenda afatit të përcaktuar zyrtarisht. Pyetësori në përgjithësi në përmbajtjen e tije ka përmbledhë të dhëna të përgjithëshme si viti i përfitimit të biznesit, Komuna, përkatësia etnike, veprimtaria e biznesit duke u thelluar në pyetje specifik që lidhen direkt me qëllimin dhe objektivat që kjo skemë ka për qëllim të përmbushë përmes financimit të sektorit privat. Gjitha përgjegjet janë analizuar dhe paraqitur edhe në formë grafike përmes përqindjeve dhe vlerave numerike si mëposht.

14.1. Në pyetjen e  parashtruar nëse përfituesit janë përfitues të vitit 2018 apo 2019 , 69.9% e përfituesve kanë qenë përfitues të skemës së granteve PZHRB të v. ( 2019 ) dhe 30.1% përfitues të PZHRB v.(2018).

*Graf 11, paraqitje e përfituesve sipas viteve (2018-2019)*




14.2. Me qëllim të identifikimit të përkatësisë etnike të përfituesve në pyetjen e parashtruar, nga njëqind e pesë (105) përfitues që janë përgjigjur në këtë pyetje ,

shohim se nëntëdhjetë (90) përfitues që janë përgjigjur i kanë takuar përkatsisë etnike kosovar, nëntë (9) boshnjak, dy (2 )egjiptian, një (1) goran, një (1 )rom , një (1) serb dhe një (1) turk. Kjo shpërndarje në baza etnike përfshin periudhen e viteve (2018 dhe 2019) të implementimit të PZHRB-së.

*Graf 12, përkatësia etnike e përfituesve PZHRB (2018-2019)*




14.3. Përfituesit e Komunës së Prizrenit janë përfituesit që janë përgjigjur më së shumti në numër prej pesëmbëdhjetë (15) të përgjigjur në pyetjen se nga cila Komunë jeni përfitues për vitet 2018-2019,duke vijuar me Komunën e Mitrovicës me katërmbëdhjetë (14) përgjegje dhe Komunën e Prishtinës me dhjetë (10) të përgjigjur.

*Graf 13, përfituesit sipas komunave PZHRB (2018-2019)*




14.4. Për të pasë një orjentim më të mirë dhe saktësi të të dhënave në vazhdën e pyetjeve tona kemi kërkuar që të marrim përgjegje edhe për pozicionin e përfituesit në biznes. Në grafikonin e mëposhtëm shohim se 72,3% e përfituesve që janë përgjigjur kanë qenë vet pronar/aksionar të biznesit, 31.3 % drejtor/drejtor ekzekutiv , 12% menaxherë dhe 3.6% të pozicioneve tjera që përfituesit nuk i kanë specifikuar.

*Graf 14, pozicioni i të intervistuarve në biznes   PZHRB (2018-2019)*




14.5. Nga paraqitja grafike e të dhënave, në grafikonin e mëposhtëm nr.15 shohim se 54.2% e bizneseve të përfituesve veprimtari të tyre kanë prodhimin ,57.8% zhvillojnë shërbime që konsiderohet veprimtaria më e madhe në numër sipas të dhënave të pranuara për dy vite (2018-2019) dhe veprimtaria e tretë është tregtia në një përqindje më të vogël prej 12%.

*Graf 15 , sektori në biznes, PZHRB (2018-2019)*




14.6. Sa i përket pyetjes që është parashtruar përfituesëve në lidhje me madhësinë e biznesit, 61.4% i takojnë bizneseve të vogla, 20.5% bizneseve të mesme,19.3% janë biznese minimale dhe vetëm 1.2% janë biznese të mëdha. Sic e dijmë ndërmarrjet janë kategorizuar sipas numrit të punëtorëve që ato kanë të punësuar.

*Graf 16 , madhësia e firmës së përfituesve PZHRB (2018-2019)*




*Graf 17 , Lotet e përfitimeve të përfituesve sipas PZHRB (2018-2019)*

14.7. Nga përgjegjet e pranuara të përfituesev të të dy viteve ( 2018-2019) për pyetjen se në cilin Lot kanë përfituar më së shumti përfituesit, shohim se numri më i madh i përfituesve kanë përfituar në Lot 1 në një përqindje prej 42.2% që nënkupton biznese te reja( Start-up) që MZHR i ka financuar deri në vlerën prej 5000€ në kuadër të PZHRB dhe Lot 3 me një përqindje prej 30.1% ku kategorizohen bizneset egzistuse mbi 2 vite funksionim të cilat janë financuar nga MZHR në vlerën prej 15.000-25.000€ .Ndërsa numrin më të vogël të përfituesve MZHR e ka pranuar në Lot 2 me një përqindje prej 27.7% ku hyjnë gjitha bizneset egzistuse mbi 2 vite funksionim. Këtë Lot MZHR e ka financuar në vlerën prej 5.000 -15.000€ gjatë viteve (2018-2019).




14.8. Duke konsideruar që për MZHR-në dhe mandatin e sajë është shumë e rëndësishme që përmes kësaj skeme tju ndihmohet bizneseve sa më shumë në zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese apo shërbimeve në mënyrë që të kemi biznese sa më të qëndrushme, shohim se nga përgjegjet e pranuara MZHR ka pasur një ndikim mjaft pozitiv për dy vite implementim të PZHRB-së ( 2018-2019) . Në 43.4 % të përfituese ky program ka pasë ndikim të lartë dhe 20.5 % ndikim shumë të lartë që konsiston në përgjithësi në një përqindje shumë pozitive në impkatin që MZHR synon ta marrë nga PZHRB për mbështetjne e sektorit privat.

*Graf 18 , Ndikimi i financimit në zgjerimin e kapacitetve( prodhuese- shërbyese) sipas PZHRB (2018-2019)*




14.9.Në grafikonin e mëposhtëm mund të shohim përqindjet e gjeneruara për sa i përket ndikimit që ka pas PZHRB gjatë viteve (2018-2019) në rritjen e nr. të klientëve

dhe konkurrueshmërisë në treg. Nga të dhënat e pranuara nga përfituesit shohim se 46.3% e tyre kanë dhënë përgjegje të një ndikimi të lartë ,34.1% të një ndikimi mesatar dhe 15.9% të një ndikimi shumë të lartë. Nëse marrim parasysh një mazhë të përgjithëshme të përqindjes mund të themi se PZHRB në mbi 50% të bizneseve ka pas shumë ndikim në rritjen e klientëve si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në treg mes tyre.

*Graf 19 , Ndikimi i financimit në konkurreshmëri dhe rritjen e numrit të klinetëve sipas PZHRB (2018-2019)*




14.10. Në grafikonin nr.20 është kërkuar që përfituesit të japin përgjigjet e tyre se sa PZHRB ka ndikuar në rritjen e qarkullimit tek bizneset e tyre përfituese gjatë viteve 2018 dhe 2019. Nga përgjigjet e paraqitura gjithashtu edhe në grafikon mund të shohim një ndarje të përgjithshme sipas përqindjeve dhe nr.të përfituesve ku: 5-8% rritje të qarkullimit kanë pasë (7) biznese përfituese, 8-15% rritje të qarkullimir kanë pasë (6) biznese, 15-25% ,(12) biznese përfituese, 25-30%, vetëm (3) biznese, 30-35%, kanë rritur qarkullimin (14) biznese me numrin më të madh të biznese sipas përqindjes së rritjes të qarkullimit,35-40%, (9) biznese përfituese, 40-50%, (12) biznese përfituese, 50-70% , rritje në qarkullim kanë pas (8) biznese, 70-80% vetëm (3) biznese, 80-85%, (2) biznese dhe 85-100% janë (4) biznese që konsiderojnë që kanë pasë këtë rritje të qarkullimit me finncimin që kanë pranuar nga PZHRB gjatë viteve (2018-2019). Nga këto të dhëna numrin më I madh I bizneseve rritjen e qarkullimit e ka pas mes vlerave 30-35%.

*Graf 20 , Ndikimi i financimit në rritjen e qarkullimit të biznesit sipas PZHRB (2018-2019)*




14.11. Rritja e eksportit dhe zëvendësimi i tijë me importin është synim strategjik i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal,me qëllim të reduktimit sa më të madh të pabarazive ekonomike, dhe zhvillimit ekonomik të balancuar në tërë territorin e Kosovës . Në bazës të kësaj PZHRB ka për qëllim të krijojë rajone zhvillimore të qëndrushme dhe konkurueshme ekonomike. Mbështetja e bizneseve në rritjen e eksportit të tyre dhe zvogëlimin e importit është stimuluar gjithmonë nga MZHR. Nga grafikoni i mëposhtëm shohim se MZHR ka pasë një ndikim të mirë me një përqindje prej 43.7% për këto dy vite (2018-2019) duke konsideruar që eksportimi i mallrave dhe produkteve shpesh në Kosovë mbështet nga një legjislacion i cili shpesh edhe ka krijuar vështirsi te bizneset në realizimin e tijë.

*Graf 21 , Ndikimi i financimit në rritjen e eksportiti dhe zëvendësimin e importit sipas PZHRB (2018-2019)*




14.12. PZHRB gjatë dy viteve të implementimit të sajë ka punësuar rreth 1312 të rinjë në gjithë territorin e Kosovës . Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se 47.6% e përgjegjeve konsistojnë në krijimin që PZHRB ka krijuar vende të reja të punës të qëndrueshme me potencial të bizneseve për të punësuar punëtor të rinj. 42.9% janë përgjigjur në ndikimin qe ka PZHRB ne krijimin e vendeve të punës mesatarisht të qëndrushme si dhe me nevojen e rritjes së numrit të punëtorëve dhe është një

përqindje më e vogël e bizneseve prej 7.1% nuk kanë arrit ti mbajnë dhe e kanë zvogëluar numrin e punëtorëve.

*Graf 22 , Ndikimi i PZHRB (2018-2019) në krijimin e vendeve të reja të punës*




14.13. Sa i përket punësimit në baza gjinore dhe etnike shohim se 83.3% kanë arritur të punëjsonë një numër prej 1-5 punëtor në ndërmarrjet e tyre dhe 11.9% kanë arritur të punësojnë një numër më të madh prej 5-10 punëtor. Më së shumti janë punësuar persona të komunitetit shumicë kosovar në një përqindje prej 71.4%, duke viju me komunitetin boshnjak në përqindjen prej 7.1% , komunitetin rom, ashkali, egjiptas prej 3.6% dhe me komunitetin turk dhe serb me një përqindje prej 2.4%.

*Graf 23 , Ndikimi i PZHRB (2018-2019) në krijimin e vendeve të reja të punës sipas përkatësisë etnike*




14.14. Në pyetjen se pas kalimit të periudhës monitoruese prej dy(2) viteve nga MZHR , a do të aplikoni përsëri në programin e MZHR-së për mbështetjen e sektorit privat ? (86.9%) janë përgjigjur pozitivisht në këtë pytje i cila është mjaft domethënëse për ne si Institucion dhe motivuese për të vazhduar edhe më tutje me avansimin e kësaj

Skeme për mbështetjen e sektorit privat si dhe ndikimit në zhvillimin socio ekonomik të balancuar që ka pas dhe ka kjo skeme ende.

*Graf 24 ,paraqitja grafike e përfituesve që planifikojnë përsëri të jenë pjesë e PZHRB në vitet në vijim*




14.15 MZHR mbetet gjithmonë e përkushtuar për të avansuar edhe më tutje si me sistemin online të aplikimit në SMAED si dhe aspekteve tjera teknike të dokumentacionit, afatit dhe vizitave monitoruese në terren.Në pyetjen se cka nuk ju ka pëlqyer nga MZHR gjatë procesit të implementimit të skemes së Granteve (2018-2019), 29.2% kanë pasë vërejtje në afatin e vlerësimit duke e konsideruar të tej zgjatur, 22.2% në pakon e dokumenteve të kërkuara për aplikim dhe afatin e aplikimit, 20.8% kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në dokumentacionin shtesë që është dashur të plotësohet pas shpalljes si përfitues i para kualifikuar,15.3% e përfituesve nuk kanë qenë të kënaqur me paraqitjen dhe komunikimin e përfaqësuesve të MZHR-së dhe 8.3 % kanë shpreh pakanqësitë e tyre në procesin e monitorimit dhe vizitave në terren. Përqindja më e madhe prej 34.7% e përfituesve ka qenë në arsyet tjera që nuk janë listuar nga ne mirëpo nuk janë sqaruar as nga përfituesit në pyetësorin e shpërndarë.

*Graf 25 ,sygjerimet dhe vërejtjet e përfiuesve për PZHRB*

12. Çka nuk ju ka pëlqyer nga MZHR, gjatë gjithë procesit të implementimit të Skemës së Granteve dhe cilat janë vërejtët/sugjerimet e Juaja(përgjigje të shumëfishta)?




## XV.PËRFUNDIME

Viti 2019 është viti i dytë i implementimit të Programit për Zhvillim Rajonal të balancuar (2019), ku MZHR ka arrit të përmbush synimet dhe planifikimet e saj për avancim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar duke rrit edhe shumën totale të këtij programi për këtë vit në krahasim me vitin e kaluar në vlerë totale prej 2,387,769.45€

Përmes PZHRB (2019), është stimuluar një numër i mirë i bizneseve në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Gjatë gjithë procesit të realizimit të këtij programi, është aplikuar një qasje konstruktive dhe profesionale ndaj aplikantëve, si psh: realizimit të sesioneve informuese në secilin rajon, për sqarimin e Programit dhe procedurave të aplikimit, ofrimit të përgjigjeve përmes ueb faqes në pyetjet e parashtruara nga aplikantët gjatë procesit të aplikimit, koordinimit dhe bashkëpunimit me AZHR-të për pranimin e aplikimeve nga aplikantët, si dhe publikimit të në ueb faqe të Udhëzuesve ku kanë qenë te specifikuara në detaje të gjitha kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2019.

Implementimi i këtij Programi në shumë prej 2,387,769.45 milion euro, përmes përkrahjes së bizneseve të reja me potencial rritje, punësimit të 751 përsonave, si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve dhe stimulimin e eksportit të produkteve vendore, ka ndikuar pozitivisht edhe në mirëqenjen e përgjithëshme të qytetarëve. Është inkurajues fakti se nga 201 projekte, 55 projekte udhëhiqen nga gjinia femërore. Në rajonin në të cilin më së shumti kanë përfituar gratë, është Rajoni Zhvillimor Qendër (Prishtina me komunat për rreth). Ajo çka duhet ti kushtohet më tepër rëndësi, është stimulimi i aplikimit nga komunitetet jo shumicë. 18% e përfituesve nga komunitetet tjera, është një shifër jo e ulët por që mund të promovohet për ngritje edhe më të madhe. Rritja e buxhetit nga viti 2018 që ishte 1.4 në 2.4 në vitin 2019, është një argument shtesë për rritje edhe të numrit të përfituesve.

Bazuar në këtë MZHR ka avancuar teknikisht për vitin 2019 sistemin e aplikimit, duke e transferuar nga një sistem klasik në letër, në një sistem elektronik online të aplikimit – SMAED. Ky sistem, ju ka lehtësuar aplikantëve aplikimin duke e realizuar këtë aktivitet edhe nga shtëpia,përmes plotësimit të gjithë dosjes në formular të caktuar. Me funksionalizimin e Sistemit SMAED, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka synuar të arrijë: ekonomizimin dhe efektshmërinë në kohës gjatë procesit të aplikimit, avancimim e nivelit të aplikimit, të rrit transparencën dhe llogaridhënjen në raport me aplikantët dhe përshpejtimin e proçesit të vlerësimit. Gjatë procesit të vlerësimit shpesh është vërejtur që projketet e Start –Up –ve kanë qenë projekte të varfëra tekstualisht në përshkrimin e objektivave dhe kritereve që kanë qenë të parapara në Udhezues, gjë që obligon MZHR-në të zhvilloj politika dhe programe për avansimin e kapaciteteve humane për të pranuar sa më shumë projekte profesionale dhe të implementueshume.Gjithashtu nga gjitha të dhënat e gjeneruara nga pyetësori i realizuar me përfituesit dhe sygerimeve të pranuara, MZHR do të mbetet e përkushtuar edhe në vazhdim që maksimalisht të avansohet si nga aspekti teknik poashtu edhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve humane, në mënyrë që ky program të avancohet cdo herë e më shumë dhe qëllimi i tijë të arrihet të bëhet i qartë në nivel sa më transparent, më profesional dhe sa më afër nevojave të biznesve.

Në këtë kontekst,gjithashtu MZHR duhet të rrisë përkushtimin e krijimit të mundësive edhe me donatorë vendor dhe ndërkombëtar, në kontekst të ngritjes së kapaciteteve të interesuarve për aplikim dhe implementim të projektve në vitit në vijim.

## BURIMET E INFORMACIONIT :

- Raporti i Komsionit të Vlerësimit ( PZHRB) 2019, protokoluar me datë: ? dhe Nr.protokoli: ?
- Bazuar në Raportin financiar vjetor të protokolluar me datë ; 31.01.2019, dhe nr. Protokolli 45
- Udhëzuesi administrativ nr:01/2018 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim rajoal të balancuar PZHR 2018.
- https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/
- Raporti nga MIN
- Raporti nga MTI